



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN  
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



REKTORATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

Rektori, Prof. dr. Ramë Vataj

Nr. ref. 150

Data: 11/09/2018

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" shpallë:

## KONKURS PLOTËSUES

(afati i dytë)

PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK  
2018/2019

### I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, për vitin e parë të studimeve themelore - Bachelor, në konkursin plotësues (afatin e dytë) për vitin akademik 2018/2019, do të pranojë 1 018 studentë, prej të cilëve 872 studentë të rregullt dhe 146 me korrespondencë.
2. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Republikën e Kosovës si dhe në shtete tjera jashtë Republikës së Kosovës në kushte të njëjta të konkursit.
3. Përjashtimisht, mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Ukshin Hoti" rezervon të drejtën e pranimit të kandidatëve me nevoja të veçanta.
4. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të përmendur më lart, universiteti do të rezervojë të drejtën për regjistrimin e studentëve që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorit deri në 2% (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët).
5. Bazuar në UA nr.09/2016 MASHT, Universiteti "Ukshin Hoti" do të rezervojë deri në 12% të vendeve nga numri total i studentëve, për komunitetet pakicë, numër ky i paplotësuar në afatin e parë të cilët do të shpërndahen në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve, për secilin fakultet veç e veç.
6. Në Universitet do të pranohen edhe studentë nga shtete të tjera (të rajonit) me automatizëm, deri në 3 % të numrit total, nëse ky numër nuk është plotësuar në afatin e parë. Kandidatë josh tetas të Kosovës, konsiderohen ata kandidatë që e kanë mbaruar shkollën e mesme jashtë Kosovës, dhe shtetasit e huaj. Këta kandidatë me rastin e aplikimit, duhet ta dorëzojnë edhe nostrifikimin e diplomës nga institucionet përkatëse. Njohja (nostrifikimi) i diplomave bëhet në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë, ndërsa barasvlerësimi notave bëhet nga Zyra për Çështje Akademike në Universitetin "Ukshin Hoti".
7. Kandidatët e kualifikuar sipas pikës 4, 5 dhe 6 të konkursit, nëse arrijnë të kualifikohen sipas pikës 1 dhe 2 të këtij konkursi, atëher këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
8. Kalkulimin e numrit për vendet e rezervuara për komunitete sipas UA të MASHT nr. 09/2016 për Fakultetin e Edukimit dhe Fakultetin e Shkencave Kopjuterike e bëjnë vet njësitë akademike përkatëse.
9. Njësitë akademike për kandidatët që aplikojnë sipas pikës 3, 4, 5 dhe 6 duhet të bëjnë verifikimin e dokumentacionit para publikimit të rezultateve përfundimtare.
10. Cdo kandidat mund të konkurrojë vetëm në një program. Studentët aktual të universitetit nuk mund të riaplikojnë në ndonjë program tjetër.

11. Deklarimi i rrejtshëm në formularin për vetëdeklarim, konsiderohet vepër penale sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR.04/L-082) të Republikës së Kosovës.

## II. MËNYRA E APLIKIMIT DHE ZGJEDHJA E KANDIDATËVE

1. Kandidatët duhet ta plotësojnë formularin e aplikimit-ONLINE, nga faqja zyrtare e universitetit [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com) duke printuar aplikacionin së bashku me fletëpagesën.
2. Kandidatët nuk mund t'i dorëzojnë dokumentet nëse paraprakisht nuk kanë aplikuar online dhe nuk e kanë bërë pagesën. Dokumentet e kërkuar sipas konkursit, dorëzohen në fakultetet përkatëse.
3. Zgjedhja e kandidatëve bëhet sipas këtyre kritereve:
  - a. **Kandidatët që kanë diplomë të shkollës së mesme, por që nuk iu kanë nënshtruar provimit të maturës, si dhe kandidatët të cilët nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës:**  
*Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100:*
    - Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme dhe
    - Deri në 70% të pikëve mund të arrihen nga provimin pranues.
  - b. **Kandidatët që posedojnë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe që e kanë kaluar me sukses provimin e matures:**  
*Numri maksimal i pikëve sipas suksesit dhe provimit pranues është 100:*
    - Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme;
    - Deri në 30% të pikëve mund të arrihen nga provimi i matures, dhe
    - Deri në 40% të pikëve mund të arrihen nga provimi pranues.
4. Do të pranohen vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provimin pranues. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të lira sipas konkursit.
5. Përjashtimisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara më lartë, kandidatët të cilët aplikojnë sipas kritereve të përcaktuara në paragrafin 4, 5 dhe 6 të pikës I të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara në provim pranues.
6. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vet fakultetet.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, zgjedhja do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse pikët përsëri do të jenë të barabarta, atëher merret sukcesi nga lëndët e ngushta profesionale.
8. Komisionet përkatësisht njësitë akademike janë të obliguara që në afat sipas konkursit listën e studentëve të pranuar ta paraqesin në rektorat për protokollim dhe publikim në faqen zyrtare.
9. **Dokumentacioni për aplikim:**
  - *Certifikatën e lindjes (origjinale).*
  - *Letërnjoftimin fotokopje.*
  - *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinale ose të noterizuara).*
  - *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme dhe dëftesën e maturës (origjinale ose të noterizuara).*
  - *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
  - *Fletëaplikacionin së bashku me pagesën prej 2.50 €.*

**Vërejtje: Dokumentacioni i dorëzuar me rastin e aplikimit mbetet në dosje dhe nuk i kthehet kandidatëve deri në diplomim ose ç'regjistrim eventual të studentit.**

### III. AFATET E KONKURSIT

1. Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentacionit, bëhet prej **11.09.2018** deri më **19.09.2018** (përfshirë të dielën) nga ora 10:00-15:30.
2. Provimi pranues do të mbahet më **21.09.2018**, duke filluar prej orës 09:00 (shih tabelën me orarin e mbajtjes së provimit pranues).
3. Të gjithë kandidatët që i nënshtrohen provimit pranues duhet të kenë me vete një dokument identifikues (letërnjoftimin, pasaportën, patent shoferin).
4. Gjatë kohës së mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë. Kandidatët duhet të respektojnë dispozitat e kodit të etikës në të kundërtën do të sanksionohen.
5. **Orari i mbajtjes së provimit pranues është:**

**Më: 21.09.2018.**

Nr.	Data	Fakulteti	Programi	Prej	Deri	Grupi
1	21.09.2018	Juridik	Juridik	09:00	10:30	RR+K
2	21.09.2018	Ekonomik	Administrim Biznesi	09:00	10:30	RR+K
3	21.09.2018	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	11:00	12:30	RR+K
4	21.09.2018	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	09:00	10:30	RR
5	21.09.2018	Filologji	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	09:00	10:30	RR
6	21.09.2018	FSHK	Dizajn Softueri	12:00	13:30	RR
7	21.09.2018	FSHK	TIT – Shq. Tur. Bos	14:00	15:30	RR
8	21.09.2018	Edukim	Program Fillor- Bos dhe Tur.	13:00	14:30	RR
9	21.09.2018	Edukim	Pro. Parafillor- Shq.Bos. Tur.	13:00	14:30	RR
10	21.09.2018	FSHJM	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	09:00	10:30	RR
11	21.09.2018	FSHJM	Agrobiznes	11:00	12:30	RR

6. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet më së voni deri më: 24.09.2018 në ora 16:00 në ueb faqen zyrtare të universitetit.
7. Afati për ankesa është më: 25-26.09.2018, ndërsa shqyrtimi i tyre do të bëhet më 27.09.2018 duke filluar nga ora 10:00.
8. Rezultatet përfundimtare shpallen gjithashtu në faqen zyrtare më: 28.09.2018.
9. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar do të bëhet nga data 01.10.2018 deri më 05.10.2018 prej orës 10:00-15:00 (shih tabelën).
10. Kandidatët të cilët nuk arrijnë të regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbin mundësinë e regjistrimit, andaj luten studentët që t'i përmbahen afateve të caktuara.

Nr.	Fakulteti	Departamenti	Data e fotografimit	Ora
1	Juridik	Juridik	01-05.10.2018	10:00 - 15:00
2	Ekonomik	Administrim Biznesi	01-03.10.2018	10:00 - 15:00
		Menaxhment Ndërkombëtar	04-05.10.2018	10:00 - 15:00

3	FSHK	TIT	01-03.10.2018	10:00 - 15:00
		SD	04-05.10.2018	10:00 - 15:00
4	Edukim	Parashkollor –Sh.B.T	01-03.10.2018	10:00 - 15:00
		Fillor- Bos. Tur.	04-05.10.2018	10:00 - 15:00
5	Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	01-03.10.2018	10:00 - 15:00
		Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	04-05.10.2018	10:00 - 15:00
6	FSHJM	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	01-03.10.2018	10:00 - 15:00
		Agrobiznes	04-05.10.2018	10:00 – 15:00

**Kandidatët e pranuar me rastin e regjistrimit duhet të paraqesin:**

1. Fletëregjistrimin e plotësuar i cili merret me rastin e regjistrimit;
2. Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm) të cilat duhet të bëhen nga fotograf profesionist;
3. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin “Ukshin Hoti”, vitin e parë të studimeve e kanë falas;
4. Pagesa për një semestër për studentët e rregullt që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, është në shumën prej 25€, për studime me korrespondencë 125€.

Për informata më të hollësishme kandidatët duhet ta vizitojnë ueb faqen zyrtare: [www.uni-prizren.com](http://www.uni-prizren.com)

**I. Numri i studentëve të cilët do të pranohen në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren - sipas programeve është si në tabelë:**

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Të rreg.	Me korrespondencë	Për komunitete	Familjet e Dëshmoreve 2%	Kandidatet nga jashtë RKS-së 3%	Total
1	Fakulteti Juridik	Juridik	64	48	7	1	2	112
2	Fakulteti Ekonomik	Men.Ndërkombëtar	154	49	17	3	4	203
3	Fakulteti Ekonomik	Administrim Biznesi	161	49	15	3	4	210
4	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor	23	/	0	1	1	23
5	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor- Bos.	22	/	0	1	1	22
6	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor- Bos.	27	/	0	1	1	27
7	Fakulteti i Edukimit	Programi Fillor- Tur.	24	/	0	1	1	24
8	Fakulteti i Edukimit	Programi Parafillor- Tur.	21	/	0	1	1	21
9	F. i Shkencave Komp.	TIT	128	/	13	2	3	128
10	F. i Shkencave Komp.	SD	105	/	12	2	3	105
11	F. i Shkencave Komp.	TIT- Bos.	9	/	0	1	1	9
12	F. i Shkencave Komp.	TIT- Tur.	26	/	0	1	1	26
13	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	54	/	7	2	2	54
14	Fakulteti i Filologjisë	Gjuhë dhe Letërsi Gjerm.	5	/	1	1	1	5
15	FSHJM	Sh. e Pyjeve dhe Mjedisit	30	/	2	1	1	30
16	FSHJM	Agrobiznes	19	/	2	1	1	19

**Sqarim:**

Në tabelën e paraqitur me kuaota për nxënësit që kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake, do të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesa dhe diploma.

Përrjashtim nga vërejtja e lartpërmendur përbëjnë kandidatët të cilët vijnë nga komunat në të cilat nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë. Këta kandidatë duhet ta plotësojnë formularin për vetdeklarim lidhur me përkatësinë e tyre etnike.

**IV. LËNDËT NË PROVIM PRANUES:**

1. **Fakulteti Juridik:** Fillet e së Drejtës, E drejta Kushtetuese dhe Gjuhë Shqipe.
2. **Programi Administrim Biznesi:** Hyrje në Ekonomi, Matematikë
3. **Programi Menaxhment Ndërkombëtar:** Hyrje në Ekonomi, Matematikë
4. **Programi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe:** Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
5. **Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane:** Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
6. **Programi TIT (Shq.Tur. Bos.) dhe DS:** Kompjuterikë (programim, Baza e të dhënave, Rrjetet kompjuterike) dhe Matematikë.
7. **Programi Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit:** Matematikë, Kimi dhe Biologji.
8. **Programi Agrobiznesit:** Hyrje në Shkencat e Natyrës, Hyrje në Ekonomi dhe Matematikë.

Në Gjuhën Boshnjake:

8. **Programi Fillor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.
9. **Programi Parashkollor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.

Në Gjuhën Turke:

10. **Programi Fillor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.
11. **Programi Parashkollor:** Gjuhë amtare- testi i të lexuarit të kuptueshëm dhe Matematikë.

  
Prof. dr. Ramë Vataj  
**Rektor**

